

2024



Republika e Kosovës

Republika Kosova / Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

Raporti tremujor i punës së Prokurorit të Shtetit

Janar-Mars 2024

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtesat.....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	4
1. Informacion i përgjithshëm për Prokurorin e Shtetit.....	5
1.1 Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit.....	5
1.2 Numri i prokurorëve.....	5
2. Përmbajtja e raportit të punës së Prokurorit të Shtetit për tremujorin e parë 2024.....	6
2.1 Kallëzimet-lëndët penale në Prokurorin e Shtetit.....	6
2.2 Lëndë të bartura nga viti 2023.....	8
2.3 Lëndë të pranuar në TM1 2024.....	9
2.4 Lëndë të zgjidhura në TM1 2024.....	9
2.5 Lëndë të pazgjidhura në TM1 2024.....	10
2.6 Lëndët në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura.....	10
2.7 Norma e zgjidhjes së lëndëve sipas indikatorëve të CEPEJ.....	11
3. Lëndët – kallëzimet penale në punë sipas prokurorive.....	13
3.1 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).....	13
3.2 Prokuroria e Apelit.....	14
3.3 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.....	15
3.3.1 Vendimet gjyqësore lidhur me aktet akuzuese të PSRK-së.....	16
3.4 Prokuroritë Themelore.....	16
3.5 Parashtruesit e kallëzimeve penale.....	21
3.5.1 Parashtruesit e kallëzimeve penale për kryes madhor të veprave penale..	21
3.5.2 Parashtruesit e kallëzimeve penale për kryes të mitur të veprave penale..	22
3.6 Kallëzimet penale sipas departamenteve të prokurorive themelore.....	22
3.6.1 Kallëzimet penale në Departamentet e Krimeve të Rënda.....	23
3.6.1.1 Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryesve të njohur (madhor) të veprave penale nga Departamentet e Krimeve të Rënda të Prokurorive Themelore.....	26
3.6.1.2 Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorive.....	27
3.6.2 Kallëzimet penale në Departamentet për të Mitur.....	28
3.6.2.1 Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale në Departamentet për të Mitur të Prokurorive Themelore.....	32
3.6.2.2 Vendimet gjyqësore përkitazi me propozimet e prokurorëve për të mitur.....	32
3.6.3 Kallëzimet penale në Departamentet e Përgjithshme.....	33
3.6.3.1 Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryesve madhor të veprave penale (PP) nga Departamentet e Përgjithshme të Prokurorive Themelore.....	36

3.6.3.2	Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorive	37
3.7	Ngarkesa e prokurorëve me lëndë.....	37
4.	Krahasimi i tremujorit të parë 2024 v.s 2023	39
5.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.....	44

Shkurtesat

PSH	Prokurori i Shtetit
Këshilli	Këshilli Prokurorial i Kosovës
ZKPSH.....	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
PA.....	Prokuroria e Apelit
PSRK.....	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PTH.....	Prokuroria Themelore
DKR.....	Departamenti i Krimeve të Rënda
DM.....	Departamenti për të Mitur
DP.....	Departamenti i Përgjithshëm
PP.....	Regjistri për evidencat e kryesve madhor të veprave penale
PPS.....	Regjistri i PSRK për evidencat e kryesve madhor të veprave penale
PPM.....	Regjistri për evidencat e kryesve të mitur të veprave penale
PPN.....	Regjistri për evidencat e lëndëve të ndryshme penale
PPP.....	Regjistri për evidencat e kryesve të panjohur të veprave penale
NJN.....	Regjistri për evidencat e ndihmës juridike ndërkombëtare
TM1.....	Tremujori i parë

Përmbledhje ekzekutive

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni në fuqi e përcaktojnë se Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për hetimin dhe ndjekjen penale të personave të dyshuar për vepra penale, siç është përcaktuar me ligj.

Në përputhje me mandatin ligjor, Prokurori i Shtetit siguron dhe publikon informacione dhe të dhëna për aktivitetet e realizuara gjatë vitit.

Raporti i Prokurorit të Shtetit për tremujorin e parë të vitit 2024, përmban aktivitetet kryesore të këtij institucioni, me fokus në pasqyrimin e punës përmes të dhënave statistikore, analitike dhe krahasuese.

Raporti ofron informacion të përgjithshëm për punën e Prokurorit të Shtetit. Gjithashtu, pasqyron kallëzimet-lëndët penale të trashëguara, të pranuar në punë dhe ato të kryera nga ana e prokurorëve dhe prokurorive në të gjitha nivelet e sistemit prokurorial, departamentet përkatëse të prokurorive përfshirë edhe të dhënat për parashtruesit e këtyre kallëzimeve.

Përkundër sfidave të shfaqura në këtë periudhë, Prokurori i Shtetit ka arritur që të tregoj një performancë të lartë në punën e tij.

1. Informacion i përgjithshëm për Prokurorin e Shtetit

Prokurori i Shtetit është institucion kushtetues i pavarur, i paanshëm dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale siç përcaktohen me ligj.

Prokurorët e shtetit janë të autorizuar që të përfaqësojnë interesat publike para gjykatave të Republikës së Kosovës dhe të kërkojnë nga gjykata që të urdhërojë masa në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

Prokurori i Shtetit ka kompetencë që të negociojë dhe të pranojë marrëveshje vullnetare për bashkëpunim apo pranim të fajësisë me të pandehurin, për veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e të dëmtuarit.

Kompetencat dhe mandati i Prokurorit të Shtetit janë të përcaktuara me ligj.

1.1 Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit

Sipas legjislacionit në fuqi, Prokurori i Shtetit, ka këtë strukturë organizative:

- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit si instanca më e lartë e Prokurorit të Shtetit, me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Prokuroria e Apelit si shkallë e dytë me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës si organ prokurorial i specializuar, me juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Prokuroritë Themelore të shtrira në territorin e shtatë (7) rajoneve të Kosovës.

1.2 Numri i prokurorëve

Në periudhën raportuese, numri i përgjithshëm i prokurorëve në Prokurorin e Shtetit është 187. Nga numri i përgjithshëm i prokurorëve 110 apo 59% janë meshkuj dhe 77 apo 41% janë femra.

Në vijim paraqitet numri i prokurorëve në ZKPSH, PA, PSRK dhe departamente të PTH-ve:

	ZKPSH	Apeli	PSRK	Prishtinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Gjakovë	Ferizaj	Totali
Kryeprokurorë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	10
DKR		4		14	5	5	5	4	2	4	43
DM		1		6	1	2	1	2	1	1	15
DP		6		27	15	7	8	10	10	12	95
Prokurorë	8		16								24
Nr total	9	12	17	48	22	15	15	17	14	18	187

Tabela 1: Numri i prokurorëve në ZKPSH, PA, PSRK dhe departamente të PTH-ve

2. Përmbajtja e raportit të punës së Prokurorit të Shtetit për tremujorin e parë 2024

Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit për tremujorin e parë të vitit 2024 paraqet punën e Prokurorit të Shtetit të realizuar gjatë kësaj periudhe nga të gjitha prokuroritë e Kosovës. Ky raport është hartuar duke u bazuar në të dhënat statistikore të përgatitura nga prokuroritë, të përpunuara në nivel vendi nga zyrat përkatëse në kuadër të sistemit prokurorial.

Raporti ka një strukturë, e cila iu mundëson lexuesve që të orientohen lehtësisht dhe të informohen për rezultatet e punës, duke i paraqitur ato në mënyrë të thjeshtësuar nga disa këndvështrime.

Në këtë raport, puna e Prokurorit të Shtetit është paraqitur sipas strukturës si më poshtë:

- Raporti i punës sipas numrit të kallëzimeve-lëndëve penale të bartura nga viti paraprak, të pranuar dhe gjithsej në punë;
- Raporti për parashtruesit e kallëzimeve penale;
- Raporti i punës sipas prokurorive;
- Raporti i punës sipas departamenteve dhe
- Raporti i punës sipas efikasitetit të prokurorive;
- Ngarkesa e prokurorëve me lëndë dhe efikasiteti i prokurorëve sipas departamenteve dhe prokurorive;
- Krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

2.1 Kallëzimet-lëndët penale në Prokurorin e Shtetit


Prokurori i Shtetit (PSH) gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, në të gjitha prokuroritë dhe të gjithë regjistrat (PP, PPM, PPN, NJN, PPP) ka pasur në punë gjithsej 112,551 kallëzime lëndë penale, prej tyre:

- 99,422 kallëzime – lëndë penale janë të bartura;
- 13,129 lëndë-kallëzime penale janë të pranuar;

Në periudhën raportuese, efikasiteti i prokurorive është si më poshtë:

- 10,585 kallëzime – lëndë penale janë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente;
- 101,966 lëndë - kallëzime penale janë të pazgjidhura;


Prokuroritë kanë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente 2,544 kallëzime-lëndë penale, përkatësisht 19.37% më pak se sa që janë pranuar, gjatë periudhës raportuese:



Grafikoni 1. Kallëzimet-lëndët penale të bartura, të pranuar, të zgjidhura, të pazgjidhura dhe gjithsej lëndë në punë në TM1 2024

Numri i përgjithshëm i lëndëve sa kanë qenë në punë (112,551), janë të shpërndara si më poshtë:


- ZKPSH 362 lëndë;
- Prokuroria e Apelit 2,266 lëndë;
- PSRK 2,027 lëndë, dhe
- Prokuroritë themelore 107,896 lëndë;



Grafikoni 2. Kallëzimet – lëndët penale në punë sipas prokurorive në TM1 të vitit 2024

2.2 Lëndë të bartura nga viti 2023


Nga viti 2023 në vitin 2024 janë bartur gjithsej 99,422 lëndë-kallëzime penale në të gjitha departamentet dhe sipas të gjithë regjistrave të prokurorive si më poshtë:



Grafikoni 3. Kallëzimet – lëndët penale të bartura nga viti 2023

2.3 Lëndë të pranuar në TM1 2024


Gjatë vitit 2024 janë pranuar në punë 13,129 kallëzime-lëndë penale, prej të cilave sipas regjistrave janë si më poshtë:



Grafikoni 4. Kallëzimet – lëndët penale të pranuar në TM1 të vitit 2024

2.4 Lëndë të zgjidhura në TM1 2024


Në TM1 të vitit 2024, nga gjithsej 112,551 kallëzime-lëndë penale sa kanë qenë në punë janë zgjidhur gjithsej 10,585 sipas regjistrave të prokurorive përfshirë këtu edhe ZKPSH-në, Prokurorinë e Apelit dhe PSRK-në, si më poshtë:



Grafikoni 5. Kallëzimet – lëndët penale të zgjidhura në TM1 të vitit 2024

2.5 Lëndë të pazgjidhura në TM1 2024


Në fund të TM1 të 2024, të pazgjidhura kanë mbetur 101,966 kallëzime-lëndë penale, prej të cilave janë:



Grafikoni 6. Kallëzimet – lëndët penale të pazgjidhura në fund të TM1 të vitit 2024

2.6 Lëndët në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura

Numri i kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të mbetura në fund të TM1 të vitit 2024, sipas regjistrave pasqyrohen në grafikonin në vijim.



Grafikoni 7: Kallëzimet-lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe ato të pazgjidhura në fund të tremujorit të parë të vitit 2024

Sipas pasqyrimit në grafikonin 7, numri më i madh i kallëzimeve-lëndëve penale në punë i përket:


- Kryesve të panjohur (PPP) të veprave penale me 74,617 ose 66.29%;
- Kryesve madhor (PP) të veprave penale, me 16,672 ose 14.81%;
- Lëndë të ndryshme penale (PPN) me 16,459 ose 14.62%.

Sa i përket llojeve tjera të lëndëve penale, ato marrin pjesë në numrin e përgjithshëm të kallëzimeve-lëndëve penale me përqindje të vogël, siç janë:

- Kallëzimet penale të kryesve të mitur me 1,675 ose 1.48%;
- Lëndët penale të Prokurorisë së Apelit me 2,266 ose 2.01%, dhe
- Llojet tjera të lëndëve penale me 0.76%.


2.7 Norma e zgjidhjes së lëndëve sipas indikatorëve të CEPEJ

Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit në TM1 të vitit 2024 sipas indikatorëve të CEPEJ paraqitet si më poshtë:




Grafikoni 8: Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit në tremujorin e parë të vitit 2024 sipas indikatorëve të CEPEJ

Krahasuar me TM1 të vitit 2024 norma e zgjidhjes së lëndëve në po këtë periudhë të vitit 2022, sipas indikatorëve të CEPEJ, paraqitet si më poshtë:



Grafikoni 9: Norma e zgjidhje së lëndëve nga Prokurori i Shtetit 2022 v. 2024 sipas indikatorëve të CEPEJ

Krahasuar me TM1 të vitit 2023 norma e zgjidhjes së lëndëve në po këtë periudhë të vitit 2024, sipas indikatorëve të CEPEJ, paraqitet si më poshtë:



Grafikoni 10: Norma e zgjidhje së lëndëve nga Prokurori i Shtetit 2023 v. 2024 sipas indikatorëve të CEPEJ


3. Lëndët – kallëzimet penale në punë sipas prokurorive

Për të parë ngarkesën dhe rezultatet e punës së secilës prokurori gjatë TM1 të vitit 2024, do të paraqiten të dhënat si më poshtë.

3.1 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH)

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit gjatë kësaj periudhe ka pasur në punë 362 lëndë penale. Prej tyre, 7 ose 1.93% kanë qenë lëndë të pazgjidhura nga periudhat paraprake, kurse 355 ose 98.06%, janë lëndë të cilat janë pranuar në punë gjatë periudhës raportuese.

Nga numri i lëndëve në punë gjatë periudhës raportuese (362), prokurorët në ZKPSH kanë zgjidhur 343 ose 94.75%, kurse në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pazgjidhura 19 ose 5.24% të lëndëve.




Grafikoni 11. Kallëzimet-lëndët penale të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura nga ZKPSH në TM1 të vitit 2024

3.2 Prokuroria e Apelit

Në periudhën raportuese, Prokuroria e Apelit ka pasur në punë gjithsejtë 2,266 lëndë penale. Nga lëndët në punë 2,266 apo 100%, janë lëndë të pranuar gjatë këtij tremujori pasi që në Prokurorinë e Apelit asnjë lëndë nuk është bartur nga viti paraprak.

Nga të gjitha lëndët në punë, 773 ose 34.11% i përkasin DKR, 143 ose 6.31% i përkasin DM ndërsa 1,350 ose 59.57% i përkasin DP.

Prokuroria e Apelit, gjatë periudhës raportuese nga lëndët në punë i ka përfunduar 2,266 ose 100% lëndëve, kurse në fund të periudhës raportuese nuk ka mbetur asnjë lëndë e pazgjidhur.



Grafikoni 12. Kallëzimet-lëndët penale të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në Prokurorinë e Apelit gjatë TM1 të vitit 2024

3.3 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) gjatë periudhës raportuese, ka pasur në punë gjithsejtë 2,027 kallëzime - lëndë penale, si në tabelën në vijim:

Nr.	Emri i të dhënave	Të pazgjidhura në fillim të tremujorit të parë të vitit 2024	Të pranuar në punë gjatë tremujorit të parë të vitit 2024	Gjithsej në punë gjatë tremujorit të parë të vitit 2024	Gjithsejtë të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2024	Gjithsejtë të pazgjidhura në fund të tremujorit të parë të vitit 2024
1	Kryesit madhor të v.p. PPS	568	68	636	15	621
2	Kryesit e mitur të v.p. (PPM)	1	1	2	0	2
3	Kryesit e panjohur të v.p. PPP	524	2	526	2	524
4	Lëndët e ndryshme penale PPN	662	47	709	22	687
5	Lëndët e ndihmës juridike ndërkombëtare	138	16	154	12	142
Gjithsej		1,893	134	2,027	51	1,976

Tabela 2: Kallëzimet - lëndët penale të bartura nga vitet paraprake, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në PSRK

Grafikoni në vazhdim tregon për numrin e lëndëve të mbetura nga vitet paraprake, lëndët e pranuar, numrin e lëndëve sa ishin në punë, numrin e lëndëve të zgjidhura dhe po ashtu numrin e lëndëve të mbetura si të pa zgjidhura.



Grafikoni 13: Kallëzimet – lëndët penale të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, të pranuar në punë, gjithsejtë në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese

Nga numri i kallëzimeve penale të kryesve madhor të veprave penale (PP) në punë, nga 636 kallëzime penale me 2,772 persona, PSRK gjatë periudhës raportuese, ka arritur që t'i procedoj në organet kompetente 15 kallëzime penale ndaj 149 personave, kurse në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur të pazgjidhura 621 kallëzime penale me 2,623 persona.

Numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur (PPM) në punë ka qenë 2 kallëzime penale me 8 persona, PSRK gjatë periudhës raportuese, nuk ka arritur që të procedoj në organet kompetente këto kallëzime penale, kurse në fund të periudhës raportuese kanë mbetur si të pazgjidhura.

Procedura hetimore në punë janë ndaj 1,046 personave, rastet e 956 ose 91.39% të personave kanë qenë hetime të pazgjidhura nga periudha paraprake, kurse ndaj 90 ose 8.60% të personave aktvendimi për hetim është marrë gjatë periudhës raportuese.

Rastet e 149 personave kanë përfunduar në këtë mënyrë:

- Ndaj 76 ose 51.00% të personave është ngrit aktakuzë pas hetimeve;
- Ndaj 40 ose 26.84% të personave janë pushuar hetimet;
- Ndaj 23 ose 15.43% të personave është hedhur kallëzimi penal dhe
- Ndaj 10 ose 6.71% cedim në kompetencë.

Në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pa përfunduara hetimet ndaj 930 ose 88.91%, të personave, sa ishin në punë.

3.3.1 Vendimet gjyqësore lidhur me aktet akuzuese të PSRK-së

Gjyqtarët e gjykatave themelore duke vepruar sipas akteve akuzuese të PSRK-së kanë marrë 101 vendime gjyqësore prej tyre;


- Aktgjykime fajësuese 48 ose 47.52% të personave;
- Hudhje e aktakuzës ndaj 4 ose 3.96% të personave;
- Aktgjykime liruese ndaj 48 ose 47.52% të personave;
- Aktgjykime refuzuese ndaj 1 personave ose 0.99% të personave.

Prokurorët e PSRK-së kanë parashtruar 5 ankesa përkitazi me vendimet gjyqësore. Prej tyre 3 ose 60%, janë parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, prej të cilave 1 ankesë është aprovuar.

3.4 Prokuroritë Themelore


Në periudhën raportuese, prokuroritë themelore kanë pasur në punë 107,896 lëndë - kallëzime penale, prej tyre:

- 97,522 kallëzime - lëndë penale të bartura nga viti 2023, ndërsa
- 10,374 kallëzime - lëndë penale të pranuar në punë
- 7,925 kallëzime - lëndë penale të zgjidhura
- 99,971 kallëzime - lëndë penale të pazgjidhura




Grafikoni 14: Kallëzimet – lëndët penale të PTH-ve të bartura nga viti 2023

Në grafikonin në vijim pasqyrohen të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale të pranuar në punë në prokuroritë themelore gjatë tremujorit të parë të vitit 2024.




Grafikoni 15: Kallëzimet – lëndët penale të pranuar në punë në tremujorin e parë të vitit 2024

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, prokuroritë themelore kanë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente 7,925 lëndë ose 2,449 lëndë më pak, apo 23.60%, e lëndëve të pranuar, si në vijim:




Grafikoni 16: Kallëzimet – lëndët penale të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2024

Në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur të pazgjidhura 99,971 kallëzime-lëndë penale, prej të cilave janë si në grafikonin më poshtë:



Grafikoni 17: Kallëzimet – lëndët penale të pazgjidhura në fund të tremujorit të parë të vitit 2024

Në grafikonin në vijim pasqyrohen në aspektin krahasues të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, sipas regjistrave në prokuroritë themelore.




Grafikoni 18: Kallëzimet-lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në tremujorin e parë të vitit 2024


Sipas pasqyrimit në grafikonin 18, numri më i madh i kallëzimeve – lëndëve penale në punë në prokuroritë themelore i përket:

- Kryesve të panjohur (PPP) me 74,091 ose 68.67%;
- Kryesve madhor (PP) me 16,036 ose 14.86%;
- Lëndë të ndryshme penale (PPN) me 15,750 ose 14.59%;
- Kryesve madhor (PPM) me 1,673 ose 1.55 dhe
- Lëndë të bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë (NJN), me 346 ose 0.32%.


Në grafikonet më poshtë do të paraqiten të dhënat për numrin e lëndëve të trashëguara, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura sipas prokurorive themelore në TM1 të vitit 2024.



Grafikoni 19: Kallëzimet-lëndët penale të trashëguara dhe të pranuar në tremujorin e parë të vitit 2024, sipas prokurorive themelore



Grafikoni 20: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, sipas prokurorive themelore



Grafikoni 21: Kallëzimet-lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, sipas prokurorive themelore

3.5 Parashtruesit e kallëzimeve penale

Kallëzimet penale gjatë periudhës së tremujorit të parë të vitit 2024, janë paraqitur nga parashtrues të ndryshëm. Më poshtë do të paraqiten parashtruesit e kallëzimeve penale sipas regjistrave.

3.5.1 Parashtruesit e kallëzimeve penale për kryes madhor të veprave penale

Në periudhën raportuese, PTH-të dhe PSRK kanë pranuar gjithsej 5.361 kallëzime penale me 6.742 persona. Këto kallëzime penale janë parashtruar nga:

- Agjencia Kundër Korrupsionit, 1 kallëzime penale ose 0.01%;
- Qytetari i dëmtuar, 227 kallëzime penale ose 4.23%;

- Personat juridik të dëmtuar, 154 kallëzime penale ose 2.87%;
- Policia e Kosovës, 4,434 kallëzime penale ose 82.70%;
- Organet e administratës – Inspektorati, 439 kallëzime penale ose 8.18%;
- Prokurorët e Shtetit me vetiniciativë, 13 kallëzime penale ose 0.24%;
- Qendra e inteligjencies financiare, 1 kallëzime penale ose 0.01% dhe
- Parashtruesit tjerë, 92 kallëzime penale ose 1.71%.

Nga të dhënat statistikore për parashtruesit e kallëzimeve penale, vërehet se numri më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 4,434 kallëzime penale ose 82.70%.

3.5.2 Parashtruesit e kallëzimeve penale për kryes të mitur të veprave penale

Departamentet për të Mitur (DM-të) të prokurorive themelore në periudhën raportuese kanë pranuar 517 kallëzime penale ndaj 800 personave të mitur. Këto kallëzime penale janë parashtruar nga:

- Policia e Kosovës, 512 kallëzime penale ose 99.03%;
- Prokurorët e Shtetit me vetiniciativë, 0 kallëzime penale ose 0%;
- Organi i Administratës-Insekcioni, 3 kallëzime penale ose 0.58% dhe
- Parashtruesit e tjerë, 2 kallëzime penale ose 0.38%.

Nga të dhënat statistikore për parashtruesit e kallëzimeve penale, vërehet se numri më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 512 kallëzime penale ose 99.03%.


3.6 Kallëzimet penale sipas departamenteve të prokurorive themelore

Në periudhën janar-mars 2024, PTH-të kanë pasur në punë 107,896 kallëzime-lëndë penale (PP, PPM, NJN, PPN, PPP) përfshirë ato të trashëguara nga vitet paraprake.

Kallëzimet – lëndët penale në punë (107,896) u përkasin:

- Departamenteve të Krimeve të Rënda 9,759 ose 9.04%;
- Departamenteve për të Mitur 2,197 ose 2.03% dhe
- Departamenteve të Përgjithshme 95,940 ose 88.91%.

Kallëzimet – lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në tremujorin e parë të vitit 2024, sipas departamenteve të PTh-ve paraqiten si në vijim:



Grafikoni 22: Kallëzimet-lëndët penale (PP, PPM, PPP, PPN, NJN) në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese sipas departamenteve të PTH-ve


3.6.1 Kallëzimet penale në Departamentet e Krimeve të Rënda

Gjatë periudhës raportuese, DKR-të e PTH-ve kanë pasur në punë gjithsej 9,759 kallëzime-lëndë penale.

Në vijim pasqyrohen kallëzimet - lëndët penale të bartura, pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura:


- Të trashëguara (nga viti 2023), 8,488 ose 86.97% kallëzime - lëndë penale;
- Të pranuar në punë 1,271 ose 13.02% kallëzime - lëndë penale;
- Të zgjidhura 1,255 ose 12.85% kallëzime - lëndë penale, dhe
- Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese 8,504 ose 87.14% kallëzime - lëndë penale.

Në vijim pasqyrohet numri i përgjithshëm i kallëzimeve - lëndëve penale në DKR-të e të gjitha prokurorive themelore:




Grafikoni 23: Kallëzimet - lëndët penale (9,759) në DKR të gjitha prokurorive themelore (PP, PPP, PPN, NJN)

Në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve-lëndëve penale të pazgjidhura në fillim tremujorit të parë të vitit 2024, (8,488) dhe numri i atyre të pranuar (1,271) në punë gjatë periudhës raportuese për secilën DKR të PTH-ve.




Grafikoni 24: Kallëzimet-lëndët penale të pazgjidhura në fillim të tremujorit të parë të vitit 2024 dhe të pranuar në punë gjatë këtij tremujori në DKR-të e PTH-ve

Në grafikonin në vijim pasqyrohen të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të mbetura si të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese për secilën DKR të PTH -ve.



Grafikoni 26: Kallëzimet-lëndët penale në punë të zgjidhura dhe ato të mbetura si të pazgjidhura në funde të periudhës raportuese gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 në DKR-të e PTH-ve

Në vazhdim pasqyrohet numri i kallëzimeve penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, në DKR për secilën PTH.



Grafikoni 25: Kallëzimet - lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2024

Krahasimi i kallëzimeve-lëndëve penale të zgjidhura në raport me lëndët e pranuar në DKR për secilën prokurori themelore:

- DKR i PTH në Prishtinë ka zgjidhur 1 kallëzime-lëndë penale më shumë se që ka pranuar, apo 100.21% e kallëzime-lëndëve penale të pranuar;
- DKR i PTH në Prizren ka zgjidhur 13 kallëzime-lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 90.78% e kallëzime-lëndëve penale të pranuar;
- DKR i PTH në Pejë ka zgjidhur 28 kallëzime-lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 81.20% e kallëzime-lëndëve penale të pranuar;
- DKR i PTH në Gjiilan ka zgjidhur 8 kallëzime-lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 95.03% e kallëzime-lëndëve penale të pranuar;
- DKR i PTH në Mitrovicë ka zgjidhur 23 kallëzime-lëndë penale më shumë se që ka pranuar, apo 118.54% e kallëzime-lëndëve penale të pranuar;
- DKR i PTH në Ferizaj ka zgjidhur 17 kallëzime-lëndë penale më shumë se që ka pranuar, apo 113.82% e kallëzime-lëndëve penale të pranuar dhe
- DKR i PTH në Gjakovë ka zgjidhur 8 kallëzime-lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 93.22% e kallëzime-lëndëve penale të pranuar.

Në përgjithësi departamentet e krimeve të rënda të prokurorive themelore gjatë tremujorit të parë 2024 kanë zgjidhur 16 kallëzime-lëndë penale më pak se sa kanë pranuar apo 98.74% të kallëzimeve-lëndëve penale të pranuar.

3.6.1.1 Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryesve të njohur (madhor) të veprave penale nga Departamentet e Krimeve të Rënda të Prokurorive Themelore

Nga kallëzimet penale (PP) të cilat kanë qenë në punë (1,619), prokurorët e DKR-ve i kanë përfunduar 364 kallëzime penale me 657 persona.

Kallëzimet penale që kanë qenë në punë për personat e përfshirë në këto kallëzime janë zgjidhur në këto mënyra:

- Me hedhje të kallëzimit penal janë zgjidhur 178 ose 27.09% të personave;
- Aktakuza pas procedurës hetimore është ngrit ndaj 253 ose 38.50% të personave;
- Hetimet janë pushuar ndaj 96 ose 14.61%, të personave,
- Janë ceduar në kompetencë rastet e 129 ose 19.63% personave (të cilat nuk konsiderohen si raste të zgjidhura) dhe
- Aktakuzë e drejtpërdrejt është ngrit ndaj 1 ose 0.15 % të personave.

Hetimi është pezulluar ndaj 4 personave ose 0.46%. Procedura hetimore është hapur ndaj 859 personave. Rastet e 525 ose 61.11% të personave kanë qenë hetime të

pazgjidhura nga periudha paraprake, kurse ndaj 334 ose 38.88% të personave aktvendimi për fillim të hetimeve është marrë gjatë periudhës raportuese.

Në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pa përfunduara hetimet ndaj 510 personave.

Gjatë periudhës raportuese, prokurorët e DKR-ve kanë parashtruar 139 kërkesa për caktim të paraburgimit për persona, nga të cilat gjykatat kanë aprovuar 121 ose 87.05% të tyre.

3.6.1.2 Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorive

Gjatë kësaj periudhe, gjykatat themelore duke vendosur sipas akteve akuzuese të prokurorëve të DKR-ve të prokurorive themelore, kanë marrë vendime gjyqësore ndaj 322 personave, si në vijim:

- aktgjykim fajësues ndaj 234 personave 72.67%;
- aktgjykim lirues ndaj 58 personave ose 18.01%;
- refuzim i aktakuzës ndaj 25 personave ose 7.76% dhe
- hedhje e aktakuzës ndaj 5 personave ose 1.55%.

Prokurorët e DKR-ve, ndaj vendimeve të gjykatave për rastet me kryes të njohur kanë parashtruar 109 ankesa nga të cilat 53 ose 48.62% janë parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin prej të cilave 24 apo 22.01% janë aprovuar.

Prokuroria	Departamenti	Lëndë me kryes të njohur (PP) për Departamentin e Krimeve të Rënda për TM1 2023									
		Trashëguara		Pranuara		Gjithsej		Zgjidhura		Pazgjidhura	
		Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
Prishtinë	DKR	638	1,983	123	329	761	2,312	147	295	614	2,017
Prizren	DKR	94	239	51	117	145	356	47	100	98	256
Pejë	DKR	61	127	24	40	85	167	25	44	60	123
Gjilan	DKR	19	55	52	96	71	151	42	83	29	68
Ferizaj	DKR	73	302	42	96	115	398	22	35	93	363
Gjakovë	DKR	102	167	28	51	130	218	35	45	95	173
Mitrovicë	DKR	271	1,021	41	58	312	1,079	46	55	266	1,024
Gjithsej PTH	DKR	1,258	3,894	361	787	1,619	4,681	364	657	1,255	4,024

Tabela 4: Kallëzimet-lëndët penale me kryes të njohur madhor në Departamentin e Krimeve të Rënda të prokurorive themelore


3.6.2 Kallëzimet penale në Departamentet për të Mitur

Gjatë periudhës raportuese, DM të PTH-ve, kanë pasur në punë gjithsej 2,197 kallëzime - lëndë penale (PPM dhe PPN/M), prej tyre:

- Të trashëguara në fillim të periudhës raportuese ishin 1,553 ose 70.68% kallëzime - lëndë penale;
- Të pranuar në punë janë 644 ose 29.31% kallëzime - lëndë penale;
- Të zgjidhura 390 ose 17.75% kallëzime - lëndë penale;
- Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese janë 1,807 ose 82.24% të kallëzimeve-lëndëve penale sa kanë qenë në punë.


Nëse marrim për bazë vetëm numrin e lëndëve të pranuar në këtë periudhë, DM-të e PTH-ve kanë arritur që t'i zgjidhin 254 kallëzime-lëndë penale më pak se që kanë pranuar ose 60.55%, e lëndëve të pranuar.

Në vijim pasqyrohet numri i përgjithshëm i kallëzimeve-lëndëve penale në DM-të e të gjitha prokurorive themelore:




Grafikoni 27: Kallëzimet-lëndët penale (2,197) në DM të të gjitha prokurorive themelore (PPM, PPN/M)

Në grafikonet në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve penale të pazgjidhura në fillim të tremujorit të parë të vitit 2024 dhe atyre të pranuar në punë në DM të PTH-ve gjatë periudhës raportuese.




Grafikoni 28: Kallëzimet-lëndët penale të pazgjidhura në fillim të tremujorit të parë të vitit 2024 dhe të pranuar në punë gjatë këtij tremujori

Në grafikonin në vijim pasqyrohen të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese për secilën DM të PTH-ve.



Grafikoni 29: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese në DM të PTH-ve.

Grafikoni në vazhdim tregon numrin e kallëzimeve-lëndëve penale të pranuar dhe të zgjidhura për tremujorin e parë të vitit 2024 për secilën DM të PTH-ve.



Grafikoni 30: Kallëzimet-lëndët penale të pranuara dhe të zgjidhura në tremujorin e parë të vitit 2024, për secilën DM të PTH-ve

Krahasimi i kallëzimeve-lëndëve penale të zgjidhura në raport me ato të pranuar në DM për secilin PTH:

- DM i PTH në Prishtinë ka zgjidhur 73 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 71.03% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar;
- DM i PTH në Prizren ka zgjidhur 39 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 45.83% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar;
- DM i PTH në Pejë ka zgjidhur 5 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 92.30 % e kallëzimeve - lëndëve të pranuar;
- DM i PTH në Gjilan ka zgjidhur 14 kallëzim - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 70.21% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar;
- DM i PTH në Mitrovicë ka zgjidhur 38 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 33.33 % e kallëzimeve - lëndëve të pranuar;
- DM i PTH në Ferizaj ka zgjidhur 28 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 60.56% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar dhe
- DM i PTH në Gjakovë ka zgjidhur 57 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 28.75% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar.

Në përgjithësi departamentet për të mitur të prokurorive themelore gjatë tremujorit të parë 2024 kanë zgjidhur 254 kallëzime-lëndë penale më pak se sa kanë pranuar apo 60.55% të kallëzimeve-lëndëve penale të pranuar.

Prokuroria	Departamenti	Lëndë me kryes të njohur (PPM) për Departamentin për të Mitur për TM1 2024									
		Trashëguara		Pranuara		Gjithsej		Zgjidhura		Pazgjidhura	
		Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
Prishtinë	DM	506	710	220	321	726	1.031	172	250	554	781
Prizren	DM	62	88	49	94	111	182	25	44	86	138
Pejë	DM	18	29	43	59	61	88	39	62	22	26
Gjilan	DM	0	0	36	58	36	58	26	44	10	14
Ferizaj	DM	120	196	63	97	183	293	43	67	140	226
Gjakovë	DM	230	407	63	98	293	505	22	24	271	481
Mitrovicë	DM	221	364	42	70	263	434	17	29	246	405
Gjithsej PTH	DM	1,157	1,794	516	797	1,673	2,591	344	520	1,329	2,071

Tabela 5: Kallëzimet-lëndët penale me kryes të njohur të mitur në Departamentin për të Mitur të prokurorive themelore

3.6.2.1 Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale në Departamentet për të Mitur të Prokurorive Themelore

Nga 1,673 kallëzime-lëndë penale për të mitur me 2,591 persona (regjistri PPM) të cilat kanë qenë në punë gjatë kësaj periudhe, prokurorët e DM të PTH i kanë zgjidhur 344 me 520 persona të mitur duke propozuar:

Aktvendim për fillimin procedurës përgatitore është marrë ndaj 207 personave të mitur.

- për 80 ose 15.38% të personave, prokurori ka vendosur që mos të fillojë procedurën përgatitore (parimi i oportunitetit);
- për 14 ose 2.69% të personave të mitur është pushuar procedura përgatitore;
- për 121 ose 23.26% të personave të mitur është hedhur kallëzimi penal;
- për 93 ose 17.88% të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa e diversitetit;
- për 40 ose 7.69% të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa disiplinore;
- për 122 ose 23.46% të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa e mbikëqyrjes së shtuar;
- për 27 ose 5.19% të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa institucionale;
- për 1 ose 0.19% të personave të mitur është propozuar urdhri për punë në dobi të përgjithshme;
- për 2 ose 0.38% të personave të mitur është propozuar të shqiptohet burgimi për të mitur;
- për 3 ose 0.57% të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm;
- për 3 ose 0.57% të personave të mitur, rastet janë zgjidhur në mënyrë tjetër dhe
- për 14 ose 2.69% të personave të mitur, rasti është zgjedhur në procedurën e ndermjetësimit.

3.6.2.2 Vendimet gjyqësore përkitazi me propozimet e prokurorëve për të mitur

Gjykatave themelore duke vepruar sipas propozimeve të prokurorëve të DM-ve të PTH-ve, kanë vendosur ndaj 165 personave dhe kanë marrë këto vendime gjyqësore:

- Aktgjykim i dënimit ndaj të miturve janë marrë ndaj 27 personave ose 16.36%;

- Aktvendime mbi shqiptimin e masës edukative janë marrë ndaj 115 personave ose 69.69%;
- Aktvendime mbi pushimin e procedurës për të mitur janë marrë ndaj 21 personave ose 12.72% dhe
- Shqiptimi i masës së diversitetit ndaj 2 personave ose 1.21%.


3.6.3 Kallëzimet penale në Departamentet e Përgjithshme

Gjatë periudhës raportuese DP të PTH-ve kanë pasur në punë gjithsej 95,940 kallëzime-lëndë penale, prej tyre:

- Të trashëguara në fillim të periudhës raportuese ishin 87,481 ose 91.18% kallëzime - lëndë penale;
- Të pranuar në punë janë 8,459 ose 8.82% kallëzime - lëndë penale;
- Të zgjidhura 6,280 ose 6.55% kallëzime-lëndë penale, dhe
- Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese 89,660 ose 93.45% të kallëzimeve - lëndëve penale sa ishin në punë.


Bazuar në numrin e kallëzimeve - lëndëve penale të pranuar në këtë periudhë, DP-të e PTH-ve kanë arritur që t'i zgjidhin 2,179 kallëzime - lëndë penale më pak se sa kanë pranuar në punë ose 74.24% të kallëzimeve-lëndëve penale të pranuar.

Në vijim pasqyrohet numri i përgjithshëm i kallëzimeve - lëndëve penale në DP të të gjitha prokurorive themelore:




Grafikoni 31: Kallëzimet-lëndët penale (95,940) në DP të të gjitha prokurorive themelore (PP, PPP, PPN)

Në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve - lëndëve penale të pazgjidhura në fillim të vitit 2024 dhe të pranuar në punë gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 në DP të të gjitha prokurorive themelore:




Grafikoni 32: Kallëzimet-lëndët penale të pazgjidhura në fillim të TM 1 të dhe të pranuar në punë gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 për DP të PTH-ve

Në grafikonin në vijim pasqyrohen kallëzimet-lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe ato të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese për secilën DP të PTH-ve:



Grafikoni 33: Kallëzimet-lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në DP të PTH-ve

Grafikoni në vazhdim tregon numrin e kallëzimeve penale të pranuar dhe të zgjidhura në tremujorin e parë të vitit 2024, për secilin DP të PTH.



Grafikoni 34: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, për secilin DP të PTH-ve

Siç shihet në grafikonin më lartë, DP i PTH në Prishtinë ka pranuar 38.77% të numrit të përgjithshëm të kallëzimeve - lëndëve penale, kurse të gjitha DP-të e PTH-ve tjera kanë pranuar 61.23% të kallëzimeve - lëndëve penale.

Po ashtu edhe sa i përket lëndëve të zgjidhura PTH në Prishtinë ka arritur që t'i zgjidh 39.81% të kallëzimeve penale, ndërsa PTH-të tjera 60.19%.

Krahasimi i kallëzimeve - lëndëve penale të zgjidhura në raport me ato të pranuar në DP për secilën prokurori themelore:

- DP i PTH në Prishtinë ka zgjidhur 780 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 76.21% e kallëzimeve-lëndëve të pranuar;
- DP i PTH në Prizren ka zgjidhur 121 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 88.66% e kallëzimeve-lëndëve të pranuar;
- DP i PTH në Pejë ka zgjidhur 152 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 83.64% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar;
- DP i PTH në Gjilan ka zgjidhur 197 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 74.97% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar;
- DP i PTH në Mitrovicë ka zgjidhur 745 kallëzime-lëndë penale më pak se që ka pranuar apo 29.18% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar;
- DP i PTH në Ferizaj ka zgjidhur 187 kallëzime - lëndë penale më pak se që ka pranuar, apo 75.68% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar dhe

- DP i PTH në Gjakovë ka zgjidhur 3 kallëzime - lëndë penale më shumë se që ka pranuar, apo 100.52% e kallëzimeve - lëndëve të pranuar.

Në përgjithësi departamentet e përgjithshme të prokurorive themelore gjatë tremujorit të parë 2024 kanë zgjidhur 2,179 kallëzime - lëndë penale më pak se sa kanë pranuar apo 74.24% të kallëzimeve - lëndëve penale të pranuar.

Prokuroria	Departamenti	Lëndë me kryes të njohur (PP) për Departamentin e Përgjithshëm për TM 1 2024									
		Trashëguara		Pranuara		Gjithsej		Zgjidhura		Pazgjidhura	
		Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
Prishtinë	DP	3,534	10,254	2,007	2,022	5,541	12,276	1,725	1,913	3,816	10,363
Prizren	DP	620	795	588	789	1,208	1,584	640	847	568	737
Pejë	DP	984	1,250	510	659	1,494	1,909	577	715	917	1,194
Gjilan	DP	51	62	455	537	506	599	416	488	90	111
Ferizaj	DP	598	941	443	546	1,041	1,487	480	552	561	935
Gjakovë	DP	944	1,587	351	465	1,295	2,052	509	650	786	1,402
Mitrovicë	DP	2,754	4,071	578	691	3,332	4,762	281	299	3,051	4,463
Gjithsej PTH	DP	9,485	18,960	4,932	5,709	14,417	24,669	4,628	5,464	9,789	19,205

Tabela 6: Kallëzimet-lëndët penale me kryes të njohur madhor në Departamentin e Përgjithshëm të prokurorive themelore

3.6.3.1 Mënyra e zgjidhjes së kallëzimeve penale të kryesve madhor të veprave penale (PP) nga Departamentet e Përgjithshme të Prokurorive Themelore

Në periudhën raportuese, DP-të e PTH-ve lëndë me kryes të njohur (PP), kanë pasur në punë gjithsej 14,417 kallëzime penale me 24,669 persona. Nga numri i lëndëve në punë 9,485 ose 65.79%, kanë qenë kallëzime penale të pazgjidhura nga vitet paraprake, kurse 4,932 ose 34.21%, janë kallëzime penale të cilat janë pranuar në punë gjatë periudhës raportuese.

Nga numri i kallëzimeve penale në punë (PP), në periudhën raportuese PTH-të kanë arritur që t'i zgjidhin 4,628 kallëzime penale ndaj 5,464 personave.

Kallëzimet e zgjidhura penale të 5,464 personave kanë përfunduar si në vijim:

- Me aktakuzë të drejtpërdrejtë i kanë përfunduar 1,798 ose 32.90% të personave;

- Me aktakuzë me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor kanë përfunduar 614 ose 11.23% të personave;
- Me hedhje të kallëzimit penal janë zgjidhur 1,073 ose 19.63% të personave;
- Me propozim për shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm janë përfunduar rastet e 15 ose 0.27% të personave;
- Aktakuza pas procedurës hetimore është ngrit ndaj 1,522 ose 27.85%, të personave;
- Hetimet janë pushuar ndaj 306 ose 5.60 %, të personave dhe
- Prokurorët gjatë periudhës raportuese kanë ceduar në kompetencë rastet e 136 ose 2.48% të personave.

Gjatë periudhës raportuese prokurorët e DP në PTH kanë parashtruar 285 kërkesa për caktim të paraburgimit, nga kërkesat e parashtruara gjykatat themelore kanë aprovuar 246 kërkesa të parashtruara ose 86.31%.

3.6.3.2 Vendimet gjyqësore përkitazi me aktet akuzuese të prokurorive

Gjykatat themelore duke vepruar sipas akteve akuzuese të prokurorëve të DP-ve kanë marrë 3,660 vendime gjyqësore prej tyre:

- aktgjykim fajësues ndaj 2,346 ose 64.09% të personave;
- aktgjykim me urdhër ndëshkimor ndaj 709 ose 19.37 % të personave;
- aktgjykim refuzues ndaj 56 personave ose 1.53% të personave;
- aktgjykim lirues ndaj 89 ose 2.43 % të personave;
- masa e trajtimit të detyrueshëm i është shqiptuar 33 ose 0.90% të personave dhe
- hudhje e aktakuzës, ndaj 427 ose 11.66 % të personave.

Gjykatat kanë marrë vendime ndaj 744 të personave për shkak të parashkrimit.

Prokurorët e DP-ve kanë parashtruar 280 ankesa përkitazi me vendimet gjyqësore. Prej tyre 159 ose 56.78%, janë parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, nga të cilat 51 apo 18.21% janë miratuar.

3.7 Ngarkesa e prokurorëve me lëndë

Bazuar në numrin e lëndëve që kanë pranuar në punë gjatë tremujorit të parë secila prokurori themelore, sipas kompetencës së departamenteve, është bërë edhe ndarja e lëndëve për secilin prokuror¹ në departamentin përkatës.

¹ Në këtë numër të prokurorëve nuk llogariten prokurorët e ZKPSH, PA, PSRK, Kryeprokurorët, Kryesuesi dhe Zëvendës kryesuesi i KPK-së si dhe anëtarët e KPK që punojnë me kohë të plotë në Këshill si dhe prokurorët që me vendim të KPK-së janë të liruar nga norma. Në numrin e prokurorëve të cilët nuk janë të ngarkuar me lëndë janë prokurorët serbë të dorëhequr në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Për të parë ngarkesën e prokurorëve me lëndë² dhe efikasitetin e tyre në zgjidhjen e lëndëve sipas departamenteve për secilën prokurori themelore të dhënat janë paraqitur në tabelën si më poshtë:

Prokuroria	Departamenti	Nr i prokurorëve	Mesatarja e lëndëve të pranuar, lëndëve në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura për 1 prokuror në raport me Normën sipas Udhëzimit Administrativ								
			Norma sipas UA		Gjithsej lëndë të pranuar	Lëndë të pranuar		Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lëndë të zgjidhura		Gjithsej lëndë të pazgjidhura
			Vjetor	Mujor		Vjetor	Mujor		Vjetor	Mujor	
Prishtinë	DKR	14	66	6	164	11.71	3.90	178	12.71	4.24	841
	DM	6	110	10	224	37.33	12.44	173	28.83	9.61	572
	DP	26	253	23	2,098	80.69	26.90	1,790	68.85	22.95	6,395
Prizren	DKR	4	66	6	62	15.50	5.17	56	14.00	4.67	163
	DM	1	110	10	52	52.00	17.33	26	26.00	8.67	90
	DP	15	253	23	634	42.27	14.09	677	45.13	15.04	1,062
Pejë	DKR	4	66	6	39	9.75	3.25	37	9.25	3.08	98
	DM	2	110	10	46	23.00	7.67	42	21.00	7.00	23
	DP	7	253	23	548	78.29	26.10	602	86.00	28.67	1210
Gjilan	DKR	4	66	6	65	16.25	5.42	56	14.00	4.67	58
	DM	1	110	10	37	37.00	12.33	27	27.00	9.00	11
	DP	8	253	23	486	60.75	20.25	437	54.63	18.21	230
Mitrovicë	DKR	3	66	6	51	17.00	5.67	58	19.33	6.44	424
	DM	1	110	10	44	44.00	14.67	17	17.00	5.67	260
	DP	4	253	23	612	153.00	51.00	283	70.75	23.58	3447
Ferizaj	DKR	4	66	6	52	13.00	4.33	36	9.00	3.00	163
	DM	1	110	10	64	64.00	21.33	43	43.00	14.33	146
	DP	11	253	23	469	42.64	14.21	492	44.73	14.91	1115
Gjakovë	DKR	2	66	6	39	19.50	6.50	45	22.50	7.50	150
	DM	1	110	10	65	65.00	21.67	22	22.00	7.33	288
	DP	9	253	23	371	41.22	13.74	518	57.56	19.19	1081

Tabela 7. Mesatarja e lëndëve të pranuar, lëndëve në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura për 1 prokurorë në raport me Normën sipas Udhëzimit Administrativ për të gjitha departamentet e PTH-ve.


² Numri i përgjithshëm i kallëzimeve-lëndëve penale pasqyron lëndët e përpjesëtuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit. Përpjesëtimi është si në vijim: lëndët NJN përpjesëtohen 6:1, lëndët PPN përpjesëtohen 8:1, lëndët PPP përpjesëtohen 20:1, në raport me lëndët PP.

Nga të dhënat në këtë tabelë shihet se të gjitha prokuroritë në të gjitha departamentet kanë pranuar lëndë nën normën e përcaktuar me udhëzimin administrativ me përjashtim të Departamentit për të Mitur.

Lidhur me efikasitetin e prokurorëve në zgjidhjen e lëndëve sipas normës së përcaktuar me udhëzimin administrativ, të gjitha prokuroritë kanë zgjidhur lëndë nën normën e përcaktuar me udhëzim administrativ.

4. Krahasimi i tremujorit të parë 2024 v.s 2023

Për të vlerësuar ngarkesën me lëndë dhe efikasitetin e prokurorive gjatë kësaj periudhe, është vlerësuar e nevojshme të bëhet edhe një krahasim i përgjithshëm me periudhën e njëjtë të vitit 2023, e cila paraqitet si më poshtë:




Grafikoni 35: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 dhe 2024

Nga të dhënat në grafikonin më lartë, shihet se në tremujorin e parë të vitit 2024 janë pranuar 1,697 kallëzime-lëndë penale më pak se në të njëjtën periudhë të vitit 2023, apo 11.44%.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 janë zgjidhur 369 lëndë më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2023, apo 3.61%.

Në grafikonin më poshtë janë paraqitur të dhënat për lëndët e pranuar dhe të zgjidhura në tremujorin e parë 2023 dhe 2024 për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorinë e Apelit dhe PSRK-në.




Grafikoni 36: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 dhe 2024 në ZKPSH, PA dhe PSRK

Nga në të dhënat e lartshënuara vërehet se ZKPSH në tremujorin e parë të vitit 2024 ka pranuar 7 kallëzime - lëndë penale apo 1.93% më pak se në vitin 2023 dhe ka zgjedhur 27 kallëzime - lëndë penale apo 7.29% më pak se në vitin 2023.

PSRK në tremujorin e parë të vitit 2024 ka pranuar 18 kallëzime - lëndë penale apo 15.51% më shumë se në vitin 2023 dhe ka zgjedhur 18 kallëzime - lëndë penale apo 26.08% më pak se në vitin 2023.

Prokuroria e Apelit në tremujorin e parë të vitit 2024 ka pranuar 196 kallëzime - lëndë penale apo 9.46% më shumë se në vitin 2023 dhe ka zgjedhur 196 kallëzime - lëndë penale apo 9.46% më shumë se në vitin 2023.

Në grafikonin më poshtë paraqiten të dhënat për lëndët e pranuar dhe të zgjidhura në tremujorin e parë 2023 dhe 2024 për të gjitha prokuroritë themelore.




Grafikoni 37: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 dhe 2024 në të gjitha prokuroritë themelore

Nga të dhënat në grafikoni 37, shihet se gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, në total prokuroritë themelore kanë pranuar numër më të vogël të lëndëve se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2023. Mirëpo nëse shihen prokuroritë veç e veç, vërehet se PTH Mitrovicë dhe Ferizaj në TM1 2024 kanë pranuar numër më të madh të lëndëve se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2023.


Sa i përket efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 në total prokuroritë themelore kanë zgjidhur numër më të vogël të lëndëve se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2023. Mirëpo nëse shihen prokuroritë veç e veç, vërehet se vetëm PTH në Gjakovë, në TM1 2024 ka zgjidhur numër më të madh të lëndëve se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2023, ndërsa të gjitha prokuroritë tjera kanë zgjidhur më pak lëndë.

Në grafikoni më poshtë paraqiten të dhënat për lëndët e pranuar dhe të zgjidhura në tremujorin e parë 2023 dhe 2024 për Departamentin për Krime të Rënda të prokurorive themelore.




Grafikoni 38: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 dhe 2024 në departamentet e krimeve të rënda

Në grafikonin më poshtë paraqiten të dhënat për lëndët e pranuar dhe të zgjidhura në tremujorin e parë 2023 dhe 2024 për Departamentin për të Mitur të prokurorive themelore.




Grafikoni 39: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 dhe 2024 në departamentet për të mitur (PPM dhe PPN/M)

Në grafikonin më poshtë paraqiten të dhënat për lëndët e pranuar dhe të zgjidhura në tremujorin e parë 2023 dhe 2024 për Departamentin e Përgjithshëm të prokurorive themelore.



Grafikoni 40: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 dhe 2024 në departamentet e përgjithshme

Në grafikonin më poshtë paraqiten të dhënat për lëndët e pranuar dhe të zgjidhura në tremujorin e parë 2023 dhe 2024 sipas departamenteve të prokurorive themelore.



Grafikoni 41: Kallëzimet-lëndët penale të pranuar dhe të zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 dhe 2024 sipas departamenteve

5. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Mandati i ZMNV-së është përfaqësimi i interesave të viktimave në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

ZMNV ka mbajtur takime të vazhdueshme me institucionet vendore, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë si OPDAT, OSCE, GIZ dhe UNWOMEN.

Gjatë tremujorit të parë 2024 janë organizuar takime, punëtori, trajnime, pjesëmarrje në grupe punuese për hartim të legjislacionit si dhe aktivitete tjera.

Në periudhën raportuese janë trajtuar dhe përfaqësuar rastet si në vijim:

- ZMNV-ja ka përfaqësuar gjithsej 680 raste gjatë tremujorit 2024. Nga rastet në punë, kanë dominuar rastet dhunës në familje me gjithsej 623 raste si dhe dhunim 11 raste. Rastet tjera janë ngacmim seksual 5 raste, trafikim me qenie njerëzore me gjithsej 3 raste, sulm seksual 5 raste, grabitje 4 rast, vrasje ne tentativë 10, vrasje 5, bashkëjetesë nene moshën 16 vjeç 2, keqtrajtimit apo braktisje e fëmijës 4 raste, degradimi i integritetit seksual 1 raste, shkelje e detyrimeve familjare 2 raste fotografimi ingjizimi i paautorizuar 1 raste dhe shkelja e KUM-it 4 raste.
- Në kuadër të ZMNV-së funksionon edhe Operatori i Linjës Ndihmëse i cili gjatë tremujorit ka pranuar 68 thirrje linjë. Kjo punon me operatorë të cilët janë të angazhuar 24 orë me një numër publik dhe pa pagesë, për t'iu mundësuar viktimave dhe publikut një mekanizëm konfidencial për raportimin e veprave të ndryshme penale të abuzimit, për informimin e viktimave dhe personave të tjerë lidhur me të drejtat e tyre dhe sigurimin e informatave të nevojshme për shërbimet ekzistuese.